

LIGJ
Nr.9268, datë 29.7.2004

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË
SIGURIMEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

Neni 2
Statusi juridik

1. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve është person juridik publik, i cili e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve është në varësi të Këshillit të Ministrave dhe e ka selinë në Tiranë.

3. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve është autoriteti i vetëm, i cili licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit, të ndërmjetësimit dhe operacioneve që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

4. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ka të drejtë:

- a) të lidhë kontrata;
- b) të nxjerrë akte rregulluese për tregun e sigurimeve, në përputhje me autoritetin që i jepet nga ky ligj dhe nga legjislacioni në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Autoriteti” është Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.
- 2. “Shoqëri sigurimi” është shoqëria tregtare e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari sigurimi.
- 3. “Shoqëri risigurimi” është shoqëria tregtare e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari risigurimi.
- 4. “Ndërmjetës” është personi fizik ose juridik i licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi.
- 5. “Këshill” është organi vendimmarrës i Autoritetit.
- 6. “Tregu i sigurimeve” është tregu i sigurimeve, risigurimeve, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga to.

Neni 4

Përgjegjësitë e Autoritetit

Përgjegjësitë e Autoritetit janë:

- a) mbajtja e një tregu sigurimesh të qëndrueshëm, efikas, transparent dhe të ndershëm, në mbrojtje të interesave të të siguruarve;
- b) siguria që sektori i sigurimeve operon mbi baza të shëndosha financiare;
- c) zbatimi i politikave në fushën e sigurimeve;
- ç) propozimi për përmirësime në legjislacionin për fushën e sigurimeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- d) ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë dhe përfitimet e tregut të sigurimeve;
- dh) vendosja dhe forcimi i marrëdhënieve me autoritetet simotra dhe institucionet e tjera vendase dhe të huaja;
- e) mbikëqyrja e aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit dhe shoqërisë së risigurimit.

Neni 5

Raportimi i Autoritetit

1. Autoriteti përgjigjet dhe raporton në Këshillin e Ministrave për ecurinë e tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë dhe për veprimtarinë e vet.
2. Autoriteti paraqet në Këshillin e Ministrave, brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës, raportin vjetor për ecurinë e tregut të sigurimeve, i cili përmban të dhëna për tregun e sigurimeve, të ndara sipas klasave të sigurimeve dhe shoqërive të sigurimeve.
3. Autoriteti raporton në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë vjetore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Ky raport përmban pasqyrat financiare të audituara të Autoritetit për vitin e fundit financiar.

KREU II

KOMPETENCAT DHE ORGANIZIMI I AUTORITETIT

Neni 6

Kompetencat e Autoritetit

Autoriteti ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) licencon veprimtarinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari;
- b) mbikëqyr veprimtarinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari;
- c) i propozon Ministrisë së Financave akte ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimit;
- ç) bën analiza financiare të veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit;
- d) ndërmerr masa korrigjuese të përshtatshme dhe në kohën e duhur në rast se një shoqëri sigurimi ose risigurimi nuk arrin nivelin e kërkuar të aftësisë paguese ose konstaton raste të mosplotësimit të aftësisë paguese, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;
- dh) ndërmerr të gjitha hapat ligjorë për ndalimin e veprimtarisë së paligjshme e të pandershme në tregun e sigurimeve dhe njofton publikun për mbrojtjen e interesave të të siguruarve;
- e) përgatit studime, analiza, publikime për zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe mbajtjen e tij të qëndrueshëm, efikas, transparent e të ndershëm;
- ë) merr pjesë si anëtar në Shoqatën Ndërkombëtare të Autoriteteve Mbikëqyrëse të Sigurimit;
- f) ushtron edhe kompetenca të tjera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

Neni 7

Organet drejtuese të Autoritetit

Organet drejtuese të Autoritetit janë:

- a) Këshilli i Autoritetit;
- b) Drejtori.

Neni 8

Këshilli i Autoritetit

1. Këshilli i Autoritetit është organ kolegjal.
2. Ky Këshill është organi vendimmarrës i politikave për realizimin e objektivave të Autoritetit dhe përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në Autoritet.

Neni 9

Emërimi i anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit dhe Kryetari i tij emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi. Vetëm për mandatin e parë, katër anëtarë emërohen me mandat katërvjeçar dhe tre anëtarët e tjerë emërohen me mandat dyvjeçar.
2. Në rast të përfundimit të mandatit, anëtari i Këshillit mbetet në detyrë deri në emërimin e anëtarit të ri.
3. Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon:
 - a) me mbarimin e periudhës kohore për të cilën ai është emëruar;
 - b) kur jep dorëheqjen, për të cilën duhet të njoftojë me shkrim një muaj më parë organin që e ka propozuar;
 - c) kur vdes.

Neni 10

Kriteret për t'u emëruar anëtar i Këshillit

Anëtar i Këshillit emërohet vetëm personi, i cili ka shtetësi shqiptare, vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, karakterizohet nga ndershmëria e pastërtia morale dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë kryer arsimin e lartë;
- b) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
- c) të ketë përvojë profesionale mbi 10 vjet;
- ç) të mos ushtrojë asnjërin nga funksionet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 11

Papajtueshmëritë e funksionit të anëtarit të Këshillit

1. Funksioni i anëtarit të Këshillit është i papajtueshëm me funksionin:
 - a) e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - b) e anëtarit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
 - c) e funksionarit të një partie politike;
 - ç) e anëtarit të organeve drejtuese të shoqërisë, aksionerit dhe çdo funksion tjetër në një shoqëri sigurimi ose në subjekte, që licencohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti;
 - d) e anëtarit të shoqërisë së auditimit, të shoqërisë së sigurimit, të shoqërisë së risigurimit dhe të shoqërisë së ndërmjetësimit.
2. Anëtari i Këshillit nuk mund të jetë aksioner i një shoqërie sigurimi në kohën e emërimit dhe gjatë ushtrimit të mandatit, si dhe për një periudhë 3-vjeçare, që nga dita e largimit të tij nga detyra.

Neni 12

Shkarkimi nga detyra

1. Anëtari i Këshillit shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave kur:
 - a) me vendim gjykatë të formës së prerë është dënuar për një vepër penale, për të cilën legjislacioni në fuqi parashikon dënim me burgim;
 - b) me vendim gjykatë të formës së prerë është ndaluar ose pezulluar të ushtrojë detyrën si nëpunës publik;
 - c) është në pamundësi fizike dhe mendore për të ushtruar funksionin e vet, të vërtetuar me raportin mjeko-ligjor apo me vendim gjykatë;
 - ç) mungon katër ose më shumë herë radhazi në mbledhjet e Këshillit të Autoritetit, pa shkaqe të arsyeshme;
 - d) shkel detyrimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të parashikuar në nenin 26 të këtij ligji;
 - dh) shkel dispozitat e nenit 11 të këtij ligji.
2. Asnjë anëtar i Këshillit nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkaqe dhe procedura të tjera të paparashikuara në këtë nen, me përjashtim të rastit kur ai jep dorëheqjen.

Neni 13 **Shpërblimet**

Anëtari i Këshillit, për punën që kryen, në përputhje me funksionet e veta, sipas dispozitave të këtij ligji, merr një shpërblim prej 30 për qind të pagës së Drejtorit Ekzekutiv, ndërsa Kryetari shpërblehet me 35 për qind të kësaj page.

KREU III KOMPETENCAT

Neni 14 **Kompetencat e Këshillit të Autoritetit**

1. Këshilli i ushtron kompetencat në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.
2. Këshilli vendos për:
 - a) dhënien ose refuzimin e licencës;
 - b) tërheqjen e pjeshme ose tërësore të licencës;
 - c) transferimin e portofolit, administrimin e përkohshëm, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë së sigurimit;
 - ç) sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;
 - d) masat e mbikëqyrjes në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;
 - dh) kufizimin ose ndalimin e investimeve të shoqërisë së sigurimit dhe të shoqërisë së risigurimit, kur vërtetohet se këto investime nuk janë në përputhje me raportet rregullatore të vendosura dhe kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë;
 - e) miratimin, brenda një muaji, të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, për çdo kontratë, që shoqëria e sigurimit kërkon të hedhë në treg;
 - ë) miratimin e pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit;
 - f) propozimin që i bëhet Ministrit të Financave për ndryshimin e tarifave të primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm, kur niveli i tyre është i pamjaftueshëm për mbulimin e rrezikut për shoqërinë e sigurimit;
 - g) miratimin dhe shpërndarjen e standardeve kontabël, si dhe formatet e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit;
 - gj) miratimin e bilancit vjetor, të projektbuxhetit, të organogramës së Autoritetit;
 - h) miratimin e raportit vjetor statistikor të tregut të sigurimeve, si dhe të raportit vjetor të veprimtarisë së Autoritetit;
 - i) miratimin e rregulloreve dhe të udhëzimeve, kur legjislacioni në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve përcakton se këto akte dalin nga Autoriteti;

j) delegimin, në raste të veçanta, të kompetencave të veta Drejtorit Ekzekutiv, me përjashtim të kompetencave për dhënien dhe heqjen e licencës së shoqërisë të sigurimit, të shoqërisë së risigurimit dhe shoqërisë së brokerimit, si dhe shpalljen e procedurave të falimentimit e të likuidimit;

k) nxjerrjen e vendimeve, rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave në ushtrim të funksioneve të veta.

3. Këshilli ushtron edhe kompetenca të tjera, që ia njeh ky ligj dhe legjislacioni në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

Neni 15

Mbledhja e Këshillit të Autoritetit

1. Këshilli mbledhet jo më pak se një herë në muaj.
2. Mbledhja e Këshillit thirret nga Kryetari me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit.
3. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, nga anëtari me mandat 4-vjeçar dhe me moshë më të madhe.
4. Mbledhja mund të thirret edhe me kërkesë me shkrim të tre prej anëtarëve të Këshillit brenda shtatë ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës me shkrim pranë sekretarisë së Këshillit.
5. Procesverbali mbahet nga sekretari i Këshillit dhe nënshkruhet në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse nga Kryetari, anëtarët pjesëmarrës dhe sekretari.
6. Këshilli miraton rregulloren “Për rregullat e funksionimit dhe të organizimit të Këshillit të Autoritetit”.

Neni 16

Kuorumi

1. Mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se pesë anëtarë. Kryetari dhe çdo anëtar i Këshillit kanë të drejtën e një vote. Kryetari i Këshillit voton i fundit. Vendimi është i vlefshëm kur votojnë jo më pak se 4 anëtarë. Votimi është i hapur dhe në asnjë rast nuk lejohet abstenimi, ndërsa vota kundër argumentohet.
2. Në mbledhjen e Këshillit merr pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv pa të drejtë vote.

Neni 17

Vendimi i Këshillit

1. Vendimet e Këshillit nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari i Këshillit.
2. Vendimet regjistrohen në një libër të veçantë dhe botohen në buletin e Autoritetit dhe në Fletoren Zyrtare, sipas rasteve, kur një gjë e tillë kërkohet nga dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

KREU IV

DREJTORI EKZEKUTIV

Neni 18

Emërimi i Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Këshilli me propozimin e Ministrit të Financave për një mandat 4-vjeçar.

Neni 19

Kriteret për t’u emëruar Drejtor Ekzekutiv

1. Drejtor i Autoritetit emërohet personi, i cili ka shtetësi shqiptare, vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, figurë të pastër morale, si dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë kryer arsimin e lartë;
 - b) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - c) të ketë përvojë pune në fushën e sigurimeve jo më pak se tre vjet ose në institucione financiare apo në administratën publike mbi 5 vjet;
 - ç) të mos ushtrojë asnjë nga funksionet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.
2. Drejtori Ekzekutiv shkarkohet nga Këshilli me propozim të Ministrit të Financave, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 20

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv ushtron këto kompetenca:
- a) drejton dhe përgjigjet për veprimtarinë e Autoritetit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët;
 - b) nënshkruan marrëveshjet në fushën e sigurimeve në emër të Autoritetit;
 - c) emëron punonjësit e Autoritetit, sipas kritereve dhe strukturës së miratuar nga Këshilli;
 - ç) propozon rendin e ditës të shoqëruar me materialin e përgatitur, të cilët ia paraqet Kryetarit të Këshillit;
 - d) ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit;
 - dh) nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e vendimeve të Këshillit;
 - e) ushtron edhe kompetenca të tjera të deleguara nga Këshilli.
2. Rregullat për funksionimin e organit ekzekutiv përcaktohen me rregullore të miratuar nga Këshilli.

Neni 21

Paga e punonjësve të organit ekzekutiv

Këshilli i Ministrave përcakton pagën e Drejtorit Ekzekutiv dhe raportet maksimale e minimale të pagave të punonjësve të organit ekzekutiv.

Neni 22

Raportimi në Këshill

- Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit raporton në Këshill çdo tre muaj dhe sa herë që i kërkohet nga Këshilli për:
- a) ecurinë e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacioneve që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari;
 - b) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli;
 - c) veprimtarinë e Autoritetit;
 - ç) çështje të tjera.

Neni 23

Njësia e auditimit të brendshëm të Autoritetit

Autoriteti kontrollohet nga njësia e auditimit të brendshëm, në përputhje me ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Neni 24

Punësimi në Autoritet

1. Nëpunësit e Autoritetit, specialistët dhe drejtuesit gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës. Rekrutimi i nëpunësve të Autoritetit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
2. Punonjësit ekzistues të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji punojnë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës civilë

në periudhë prove për një vit.

3. Këshilli përcakton:

a) pagat e personelit teknik e administrativ, sipas raportit të pagave maksimale e minimale të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

b) trajtimin financiar për efekt diete dhe orë jashtë orarit për të punësuarit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Autoriteti ka të drejtë të punësojë specialistë apo ekspertë, me kohë të pjesshme pune. Shpërblimi dhe kriteret e zgjedhjes së tyre përcaktohen nga Këshilli.

Neni 25

Konflikti i interesave

1. Çdo anëtar i Këshillit, Drejtori Ekzekutiv, si dhe nëpunësit e Autoritetit që nga çasti i emërimit dhe në vazhdim deklarojnë me shkrim respektivisht në Këshill dhe në organin ekzekutiv interesat ekonomike që ai ose personat e lidhur me të mund të kenë drejtpërdrejt për veprimtarinë e sigurimeve.

2. Çdo anëtar i Këshillit kërkon të heqë dorë ose nuk lejohet të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit, kur vërtetohet se ndërmjet tij dhe personit apo shoqërisë, për të cilën diskutohet apo shqytohet, ka lidhje bashkëshortore, gjinie, krushqie apo lidhje të tjera interesash që vënë në dyshim paanshmërinë apo objektivitetin e tij në votim.

3. Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit nuk mund të jetë në marrëdhënie tjetër punësimi përveç mësimdhënies.

4. Nëpunësi i Autoritetit nuk mund të hyjë në marrëdhënie tjetër punësimi pa miratimin paraprak me shkrim të Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 26

Konfidencialiteti

1. Anëtarët e Këshillit dhe të organit ekzekutiv, gjatë dhe pas largimit nga detyra, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, të përcaktuara si të tilla nga Autoriteti.

2. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe çdo i punësuar i Autoritetit mban përgjegjësi penale dhe civile për dëmin që mund t'u ketë shkaktuar personave të tretë, si rezultat i mosruajtjes së konfidencialitetit.

3. Konfidencialiteti nuk u kundërvihet organeve gjyqësore dhe çdo organi tjetër të autorizuar me ligj të veçantë.

KREU V

BUXHETI I AUTORITETIT

Neni 27

Të ardhurat e Autoritetit

1. Të ardhurat e Autoritetit përbëhen nga:

a) kontributet e shoqërive të sigurimit, të cilat janë deri në një maksimum prej 1,5 për qind të shumës së primeve bruto të arkëtuara nga veprimtaria e sigurimit të jo-jetës dhe kuotave të fituara nga veprimtaria e sigurimit të jetës;

b) të ardhurat nga shërbimet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

c) komisionet për shërbime suplementare;

ç) të ardhurat nga sanksionet në zbatim të legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

d) të ardhurat nga shitjet e pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të Autoritetit;

dh) të ardhurat e mbartura nga viti pararendës financiar;

e) çdo e ardhur tjetër e mundshme, sipas legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

ë) shumat e primeve bruto të arkëtuara në bazë të kontributeve, të cilat duhet të certifikohen

çdo vit nga një auditor i jashtëm i shoqërisë së sigurimit dhe çdo kontribut që rezulton i paevidentuar, do t'i paguhet Autoritetit brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i certifikatës së auditimit.

2. Autoriteti, me të ardhurat e realizuara, përballon shpenzimet për funksionimin e vet, sipas buxhetit të miratuar nga Ministri i Financave.

Neni 28

Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

2. Autoriteti, nëpërmjet Këshillit, paraqet për miratim pranë Ministrit të Financave projektbuxhetin e hollësishëm për vitin pasardhës jo më vonë se data 30 nëntor e vitit pararendës.

3. Buxheti i të ardhurave dhe i shpenzimeve të Autoritetit miratohet zë për zë nga Ministri i Financave.

4. Buxheti financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga Autoriteti. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit ushtrimor, mbarten për vitin pasardhës.

Neni 29

Kontabiliteti

1. Autoriteti mban regjistrimet kontabël, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe standardet kontabël të zbatueshme.

2. Regjistrat kontabël duhet që në çdo kohë të pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të Autoritetit.

3. Autoriteti përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia dërgon për miratim Ministrit të Financave.

KREU VI

MARRËDHËNIET E AUTORITETIT

Neni 30

Marrëdhëniet me subjektet e licencuara nga Autoriteti

Autoriteti ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë subjektet e licencuara prej tij dhe të kërkojë çdo dokument e të dhënë, që e gjykon të nevojshme për ushtrimin e mbikëqyrjes.

Neni 31

Kërkimi i të dhënave nga ekspertët kontabël të autorizuar

Autoriteti u kërkon ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit, risigurimit e ndërmjetësimit çdo të dhënë për veprimtarinë e tyre. Ekspertët kontabël të autorizuar, në përmbushje të këtij detyrimi, janë të çliruar nga kërkesa për ruajtjen e sekretit profesional ndaj Autoritetit.

Neni 32

Marrëdhëniet me institucionet vendase dhe ato të huaja

1. Autoriteti, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, bashkëpunon, shkëmben të dhëna dhe lidh marrëveshje me organet ekzekutive dhe institucionet e tjera në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, bashkëpunon, shkëmben të dhëna dhe lidh marrëveshje me autoritetet simotra dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

3. Autoriteti, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ruan konfidencialitetin e të dhënave dhe u nënshtrohet rregullave të sekretit profesional me rezervën e reciprocitetit.

KREU VII

PUBLIKIMI DHE INFORMACIONI

Neni 33

Buletini i Autoritetit

1. Autoriteti nxjerr buletin e vet, ku publikohen vendimet e Këshillit dhe të organit ekzekutiv, aktet rregullatore, njoftime, analiza, studime dhe ekzaminime për tregun e sigurimeve.

2. Autoriteti publikon, jo më pak se një herë në vit, një raport të hollësishëm për tregun e sigurimeve dhe veprimtarinë e tij.

Neni 34

Botimi në Fletoren Zyrtare

Autoriteti boton në Fletoren Zyrtare të gjitha vendimet për dhënien ose heqjen e licencës për ushtrim veprimtarie në fushën e sigurimeve, vendimet për transferimin e portofoleve të sigurimit të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit dhe shpalljen e falimentimit ose të likuidimit të një shoqërie sigurimi dhe risigurimi, si dhe të dhëna të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

Neni 35

Autoriteti krijon dhe mban rrjet informacioni me subjektet që mbikëqyr, në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

1. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, i ngritur në përputhje me nenin 76 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe/ose risigurimit", i kryen funksionet e veta deri në emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit, në përputhje me këtë ligj.

2. Këshilli i Ministrave emëron organet drejtuese dhe cakton raportin e pagave maksimale e minimale të organit ekzekutiv, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4301, datë 23.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**